REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2022:273656
Datë: 09.02.2024
Numri i dokumentit: 05305379

P.nr.11/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA NË KLINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Sabrije Rraci, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Liridona Palushi, në çështjen penale kundër të pandehurit L(B) L nga fsh. D K. K" i akuzuar për shkak të kryerjes së veprës penale ,,Legalizim i përmbajtjes së rremë" nga neni 395 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, nr PP//II.nr..../… të dates 13.01.2023, në shqyrtimin fillestar publik të mbajtur me dt. 05.02.2024 në praninë e Prokurorit se Shtetit Ramiz Buzhala nga Prokuroria Themelore në Pejë, të pandehurit L.L dhe mbrojtësit të tij av. Haxhi Sinani, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar në të njëjtën ditë gjykata shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 09.02.2024, përpiloi këtë:

A K T GJ Y K I M

Kundër:

Te pandehurit L. L, i lindur me .... në fsh. D.K. K. ku dhe tani banon, i lindur nga babai B. dhe nëna D. e gjinisë P, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, baba i 3 fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike i identifikuar me numër personal...., i nacionalitetit shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me datën ....., në kohë të pacaktuar, në Q. K, e vë në lajthim organin kompetent dhe atë organin e lartcekur, që në një dokument publik të vërtetojë një çështje të pavërtetë, në

2023:015264

atë mënyrë qe i pandehuri veturën e tipit B 5/D të vitit..., me ngjyrë të gjelbër, me targa ....., me nr. të VIN: ...., e regjistron në emrin e tij, e cila veturë pas ekzaminimit rezulton se numrin e karroserisë e ka inkorporuar përmes saldimit dhe nuk e ka sipas standardeve EuVID.

- Me çka ka kryer vepër penale ,,Legalizim i përmbajtjes së rremë" nga neni 395 par, 1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të neneve 4, 7 , 17, 38, 48, 47 dhe 69 dhe 70 dhe nenit 395 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPPRK-së e:

GJYKON

DËNIM ME GJOBË

Të pandehurin L. L, Gjykata e dënon me dënim burgu në kohëzgjatje prej tre (3) muaj, me pëlqimin e të pandehurit conform dispozitave ligjore të nenit 44 të KPRK-së, dënimi me burg iu zëvëndësua me dënim me gjobë në shumën prej 450 (Katërqind e pesëdhjetë) euro, të cilin dënim i pandehuri duhet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi

II. Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën e shqiptuat, dënimi me gjobë do të shëndrrohet në dënim me burgim duke e llogaritur 20 (njëzet) €uro për një ditë.

III..OBLIGOHET: I pandehuri qe në emer të paushallit gjyqësor të paguaj 20 (njëzetë) €, dhe tarifën për kompenzim të viktimave të krimit shumën në vlerë prej 20 (njëzet) €të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pasi aktgjykimi të merrë formën e prerë.

A r s y e t i m

1.Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzën, me shenjën nr PP//II.nr.../... të datës 13.01.2023 L.L nga fsh. D. K. Klinë, i akuzuar për shkak të kryerjes së veprës penale ,,Legalizim i përmbajtjes

2023:015264

së rremë" nga neni 395 par. 1 të KPRK-së,, duke i propozuar gjykatës qe pas administrimit të provave të pandehurin ta shpall fajtor dhe ta dënoi sipas ligjit.

Gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 05.02.2024, gjatë të cilës u dëgjuan Prokurori i Shtetit, Ramiz Buzhala i akuzuari L.L dhe mbrojtësi i tij av. Haxhi Sinani. Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i pandehuri ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale qe i vihej ne barre, me vie keq për rastin e ndodhur, dhe i njëjti deklaron se jam i penduar thellë për veprën penale të kryer. I pandehuri premton se në të ardhmën nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjajshme penale.

Gjykata kërkon mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Prokurori i Shtetit ka deklaruar se pasi që i pandehuri, e pranoj fajësinë dhe ky pranim i fajësisë është bërë me vullnet te lirë dhe pa presion nga askush, duke u mbështetur në provat materiale që gjenden ne shkresa të lënda. I propozoj gjykatës që të pranoj pranimin e fajësisë nga e të pandehurit për veprën penale që i vihet ne barre, dhe me rastin e marrjes se vendimin, lidhur me dënim, pranimin e fajësisë ta merr si rrethanë lehtësuese.

Edhe mbrojtësi i të pandehurit Haxhi Sinanaj është pajtuar me pranimin e fajësisë, i cili pranim është i vullnetshëm, pa asnjë lloj ndikimi i mbrojturi im në të gjitha fazat e procedurës penale e ka pranuar fajësinë, i njëjti është njoftuar për pasojat por edhe me benifitet e pranimit të fajësisë. Andaj duke qenë në prezencën e këtyre fakteve, propozoj qe të pranohet pranimi i fajësisë, dhe poqe e pranon gjykata pranimin e fajësisë, propozoi qe me rastin e marrjes së dënimit, si rrethanë lehtësuese te merren fakti i pranimit të fajësisë në mënyrë vullnetshme. I njëjti asnjë herë më parë nuk ka qenë i gjykuar për ndonjë vepër penale. I pandehuri është prind baba i tre fëmijëve, me një gjendje jo të mirë ekonomike. Andaj i propozoi qe ndaj të njëjtit gjykata ti shqiptoj një dënim më të holla, e me të cilin dënim do të arrihet efekti i dënimit, qe në të ardhmen mos të përsërisë vepër penale.

2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

2023:015264

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjykata, pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar fajësinë nga i akuzuari i lartcekur, për veprën penale për të cilën është akuzuar, nga se ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 242 të KPPK-së. Në këtë aspekt gjykata, ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe pas njoftimit nga ana e gjykatës lidhur me benifitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ka vlerësuar se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pas konsultimit paraprak me mbrojtësin e tij, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar:

Andaj duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike: Se i akuzuari, ka kryer veprën penale siq e ka pranuar edhe vet, Legalizimi i përmbajtjes së rremë nga neni 395 par. të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

4.Vendimi për shpalljen fajtor

Duke u bazuar në këto qe u cekën më lart, gjykata, ka vendosur që të akuzuarin, t'a shpall fajtor për kryerjen e veprave penale sipas aktakuzës së cekur më lart, meqenëse është vërtetuar se i njëjti e ka kryer veprën penale siç edhe vet e ka pranuar sikurse në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar sikurse në dispozitiv të aktgjykimit dhe për të njëjtën është përgjegjës. Kjo për faktin se e ka pranuar edhe vet.

5.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit:

Me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarës Gjykata, i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas neneve 69 dhe 70 të KPK-së.

Në këtë aspekt, si rrethanë lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka shqiptuar dënimin për veprën penale sikurse më lart, është fakti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, si dhe pendimin e tij, si rrethanë tjetër lehtësuese gjykata muar se i pandehuri, nuk është dënuar më parë, nuk ka qenë i gjykuar më parë për ndonjë vepër penale, pra është hera e parë qe ka rënë ndesh me ligjin ashtu që gjykatës i ka premtuar se nuk do ta përsërisë më vepra penale. Ndërsa, gjykata sa i përket rrethanave rënduese gjykata nuk gjeti asnjë rrethanë.

2023:015264

6.Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar.

Dënimi me gjobë në shumën prej (katërqind e pesëdhjetë) €uro, të cilin dënim i pandehuri duhet ta paguaj, pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejt, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit.

Gjykata ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, por edhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Zëvendësimi i dënimit me burgim në dendim me gjobë është bërë me pëlqimin e të pandehurit si dhe konform dispozitave ligjore te nenit 44 të KPRK-së.
Vendimi për shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor është i bazuar në nenin 449 par. 2 pika 2.6 të KPPK-së, ndërkaq vendimi për pagesën në Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit është i bazuar në nenin 36 par. 3 nënpar. 3.1 të LKVK-së.
Nga arsyet e cekura më lartë e në bazë të neneve 242 dhe nenit 364 dhe 370 të KPPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA KLINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL
P.nr.11/2023 me datë 09.02.2024

Zyrtare ligjore	Gjyqtarja
Liridona Palushi	Sabrije Rraci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejte te parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.

2023:015264